



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr. 14

Prishtinë, më 20 shkurt 2018, në orën: 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Shqipe Pantina, Jasmina Zhivković, Valon Ramadani, Fisnik Ismaili, Arban Abrashi, Imet Rrahmani, Xhevahire Izmaili, Rasim Selmanaj, Milaim Zeka dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje morën pjesë: z. Mahir Yagcilar, ministër i MAP-së dhe INPO, Ekonomia online.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Nait Hasani, kryetar i komisionit.

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 17.01.2018;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike (ReSPA);**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u plotësua me një pikë shtesë, si vijon: 3. Shqyrtimi në parim i P/ligjit për OJQ-të. Komisioni miratoi rendin e ditës me plotësimin e sipërhënuar.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike (RSPA)

Nait Hasani i njoftoi komisionin se për arsye të paqartësive në disa pjesë të P/ligjit ka ftuar Ministrin të prezantojë para komisionit për P/ligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike (RSPA), lidhur me ndryshimet të cilat janë krijuar që nga koha e ratifikimit të marrëveshjes.

Mahir Yagcilar: Shkolla Rajonale për Administratë Publike, me seli në Mali të Zi – Danilovgrad, është një shkollë e hapur nga Komisioni Evropian në kuadër të bashkëpunimit rajonal. Iniciativa për hapjen e shkollës ka filluar në vitin 2005-2006, ndërsa në vitin 2009 është ratifikuar marrëveshja nga vendet anëtare: Kroacia, Maqedonia, Serbia, Mali i Zi dhe Bosnja e Hercegovina.

Në vitin 2011 është kërkuar që edhe Kosova të anëtarësohet në shkollën rajonale-ReSPA, e cila kërkesë ishte aprovuar nga bordi i shkollës i cili përbëhej nga përfaqësuesit e vendeve anëtare, por për arsye të implikimeve buxhetore Kosova ende nuk është anëtare e shkollës rajonale.

Në RSPA, Kosova deri tani është përcjellëse e aktiviteteve të shkollës në cilësinë e vëzhgueses.

Shqipe Pantina duke ju referuar nenit 2 dhe nenit 30 të marrëveshjes, ajo pyeti se çka po ratifikohet, marrëveshja e vitit 2009, apo marrëveshja e rishqyrtuar sipas nenit 30 me tekst të modifikuar?

Xhevahire Izmaku pyeti a keni pasur bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit rreth ndonjë konflikt interesi me Ligjin për arsimin e lartë, pasi që edhe shkolla ReSPA prodhon tituj që mund të jenë të përfaqësuesit me titujt që dalin nga universitetet.

Imeti Rrahmani pyeti lidhur me koston financiare se a është vjetore apo vetëm një herë paguhet?

Arban Abrashi pyeti se a ka ndikim dhe çfarë ndikimi ka në IKAP?

Mahir Yagcilar, u përgjigj në pyetjet e anëtarëve të komisionit:

- Sa i përket koston financiare për shkollën, ajo është vjetore dhe shuma e pagesës është e njëjtë për të gjitha vendet anëtare,
- Lidhur me ndonjë konflikt interesi me Ligjin për arsimin e lartë, ai tha se kjo shkollë nuk prodhon tituj, por nga shkolla përfitojnë nëpunësit e institucioneve në përvojat e menaxhimit të administratës publike dhe ngritjen e kapaciteteve,
- RSPA – nuk ndikon në funksionimin e IKAP-it, por vetëm sa i plotëson nevojat në administratën publike dhe shkëmbimin e përvojave,
- Në aspektin e trajnimeve dhe pjesëmarrjes në ngjarjet e tjera, nëpunësit e administratës publike të Kosovës përfitojnë trajnime edhe prezantojnë në konferenca të ndryshme rreth gjendjes së Administratës Publike në Kosovë.

Konstatim: Komisioni më shumicë votash miratoi P/Ligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike (ReSPA) dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqet këtë:

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet Projektligji nr. 06/L-044, për Ratifikimin e Marrëveshjes për themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike (ReSPA).
2. Arsyetimin e raportit në Kuvend do ta paraqesë deputeti, Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Arsyetim

Komisioni Funkcional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, para shqyrtimit të Projektligjit në mbledhjen plenare, duke vepruar në pajtim me nenin 60 të Rregullores së Kuvendit, e shqyrtoi Projektligjin dhe konstatoi se Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike (ReSPA) i plotëson kushtet t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim. Për këtë arsye, ia rekomandoi Kuvendit shqyrtimin dhe miratimin e Projektligjit, në pajtim me rregullat e Rregullores së Kuvendit.

4. Shqyrtimi në parim i P/ligjit për OJQ-të;

Nait Hasani njoftoi komisionin se P/ligji është proceduar në Kuvend, sipas strategjisë legislative të Qeverisë dhe komisioni po e shqyrton para miratimit në parim, brenda afateve të përcaktuara me rregulloren e Kuvendit të Kosovës.

Në tekstin e P/ligjit ka paqartësi që ndërlidhen me regjistrimin e OJQ-ve, përgjegjësitë e OJQ-ve, mungesa e auditimit, duke pasur parasysh faktin që një numër i madh i OJQ-ve regjistrohen si organizata jo për përfitime dhe të cilat nuk e deklarojnë buxhetin e tyre, ai kërkoi sqarime se për çfarë arsye ato regjistrohen dhe cila është transparenca e tyre.

Shqipe Pantina tha se Ligji në fuqi për OJQ-të është një ligj implementues që krijon një hapësirë të mjaftueshme për veprimtarinë e OJQ-ve, por duhet theksuar se ka pasur shkelje të ligjit nga ana e disa OJQ-ve, e sidomos ato mikro-financiare të cilat në ushtrimin e veprimtarisë përveç Ligjit për OJQ, duhet t'i nënshtrohen edhe ligjeve të tjera, sidomos kontrollit të Agjencisë për Inteligjencën Financiare, sepse vetë OJQ- të mikro-financiare janë problem kryesor i keqpërdorimeve.

Milaim Zeka kërkoi përkushtim në procedurat e shqyrtimit për arsye se në Kosovë ka persona që në emër të ligjit dhe të OJQ-ve janë pasuruar.

Mahir Yagcilar, tha se p/ligji me gjithë vërejtjet duhet të miratohet, ndërsa që pas miratimit në parim me një bashkëpunim me komisionin do të evitohen vërejtjet e paraqitura.

Konstatim: Komisioni me shumicë votash miratoi në parim P/ligjin për OJQ-të, dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqet këtë:

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet në parim Projektligji nr.06/L-043 për lirinë e asociimit në Organizata Joqeveritare.
2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet, Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL shqyrton projektligjin në parim, para leximit të parë në mbledhje plenare, dhe Kuvendit i paraqet raport me rekomandime për miratim në parim.

Komisioni, pas shqyrtimit, në parim, të Projektligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në Organizata Joqeveritare, vlerësojë se projektligji i plotëson kushtet e parapara sipas nenit 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim në parim.

Mbledhja përfundoi në orën:11:10.

E përgatiti:
Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetari i komisionit,

Nait Hasani